

Mbeshtetur ne nenin 28 paragrafi 3 te Ligjit Nr 9723/2007 per Qendren Kombetare te Regjistrimit ky dokument perben:

AKTIN E  
THEMELIMIT  
DHE  
STATUTIN  
E

"CleanGen2" SHPK



## KAPITULLI I

### Data e Themelimit, Emri, Forma, Selia, Kohezgjatja

#### Neni 1.

#### Data e Themelimit dhe Emri

Shoqëria "CleanGen2" (ne vjrim "Shoqëria") e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Shpk", cili perfaqeson formen ligjore te saj, si shoqëri me pergjegjesi te kufizuar, themelohet sot me date 15.12.2020.

Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqëria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqërohet nga:

- (i) fjalet "Shoqëri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "shpk".
- (ii) numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj.
- (iii) adresa e regjistruar ,dhe
- (iv) dhe pasqyrimin e faktit qe shoqëria eshte ne procedura likuidimi, ne qoftese ky rast paraqitet.

#### Neni 2. Forma Ligjore e Shoqërise

2.1 Shoqëria eshte nje entitet ligjor shqiptar, dhe ka formen ligjore e nje shoqërie me pergjegjesi te kufizuar ("shoqëri me pergjegjesi te kufizuar"), ne perputhje me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" ("Ligji i shoqërive"), i ndryshuar.

#### Neni 3. Selia shoqërise

3.1 Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, Selia e Shoqërise ndodhet ne adresen Tirane, Njesia Administrative Nr.5, Rruga Nikolla Tupe, Pallati 1, Ap. 11, Kodi Postar 1019. Shoqëria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise. Shoqëria mund te hape degë te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikës se Shqiperise.

#### Neni 4. Kohezgjatja

4.1. Kohezgjatja e shoqërise eshte e pacaktuar.

## KAPITULLI II

#### Neni 5. Objekti i Shoqërise

5.1 Objekt i aktivitetit te Shoqërise eshte: Kryerja e investimeve ne fushen e energjise diellore apo te rinovueshme, zhvillimi, ndertimi, operimi i centraleve te prodhimit te energjise diellore apo te rinovueshme, marrja e licensave per kete veprimtari, tregtimi i energjise se prodhuar.

5.2 Pervec kesaj ne perputhje me legjislacionin shqipter, Shoqëria mund te kryeje cdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte rezultat ose lidhet me objektivin e mesiperm. Per arrijten e qellimit te mesiperm, Shoqëria mund te kryeje cdo transakcion lidhur me pasurite e luajtshme dhe te paluajteshme, dhe cdo aktivitet tjeter tregtar, financiar, qeraje ose hipoteke, qe mund te konsiderohet i viefshem ose i nevojshem ne menyre qe te ushtrohet objekti i Shoqërise.

#### Neni 6. Ndryshime

6.1. Shoqëria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe sic parashikohet ne kete Statut.

## KAPITULLI III

### Kapitali Themeltar; Kuotat

#### Article 7. Kapitali

7.1 Kapitali themeltar i Shoqërise eshte 10.000 Leke (dhjete mije Leke).



## **Neni 8. Ortakët dhe Kuotat**

8.1 Në momentin e miratimit të këtij Statuti, kapitali i Shoqërisë është i zotëruar nga Ortaku i vetëm si më poshtë:

**Z. Arben Xhabafti**, lindur më 24.04.1963 në Tiranë, mbajtes i kartës së identitetit me nr. 039834899, e nr personal G30424038T, zotëruar i një (1) kuote, e cila përfaqëson 100% të Kapitalit të Shoqërisë.

## **Neni 9. Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar**

9.1 Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me Kapitullin IV të këtij Statuti, dhe kërkesave të detyrueshme të Ligjit të shoqërive.

9.2 Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para ose me anë të kontributeve në natyrë, si dhe me përfshirjen e rezervave (nese ka) ose fitimit apo kthimit të borxhit në kapital.

9.3 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet duke emetuar kuota të reja apo duke rritur vlerën nominale të kuotave ekzistuese.

## **Neni 10. Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve**

10.1 Të gjithë vendimet e ortakëve do të regjistrohen në regjistrin e vendimeve. Vendimet e pa regjistruara në regjister do të konsiderohen të pavlefshme.

10.2 Çdo kuote i jep të drejtën, në Asamblesë të Përgjithshme të Ortakëve (Asambleja e Përgjithshme), Ortakut që e zotëron të një numri votash të barabarta me pjesëmarrjen/përqindjen e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë si dhe të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, kur deklarohet nga Ortakët e Shoqërisë.

10.3 Ortakët do të kenë akses të plotë në çdo informacion dhe të dhëna që ka lidhje me aktivitetin e Shoqërisë në çdo kohë, përfshirë të drejtën për të kontrolluar regjistrimet e Shoqërisë dhe çdo dokument tjetër.

10.4 Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Kuotave, transferohen tek çdo zotëruar i ri i këtyre Kuotave.

## **KAPITULLI IV**

### **Asambleja e Përgjithshme**

## **Neni 11. Kompetencat**

11.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi kontrollues dhe vendimarrës i Shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikën e saj ekonomike dhe tregtare.

11.2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të vendosë me një shumicë prej  $\frac{3}{4}$  e ortakëve pjesëmarrës në mbledhje pasi të jetë arritur kuorumi i kërkuar në pikën 86/1 të ligjit për shoqëritë tregtare ("Shumica e Kualifikuar") në lidhje me çështjet e mëposhtme:

(i) aprovimin e strategjisë së Shoqërisë, Planit të Biznesit, planeve financiare dhe buxhetit;

(ii) aprovimin e çdo ndryshimi në vijim në Planin e Biznesit të Shoqërisë dhe në planet financiare.

(iii) shpërndarjen e fitimeve;

(iv) aprovimin e kontratave të Shoqërisë nese nuk merret pelqimi unanimitet i te gjithë ortakëve të Shoqërisë;

(v) pezullimin e aktivitetit të Shoqërisë dhe/ose përfundimin, shpërberjen apo likuidimin e Shoqërisë;

(vi) ndryshimet, amendimet apo zëvendesimet në aktin e themelimit dhe statutin e Shoqërisë;

- (vii) ndryshimin e formes ligjore te Shoqerise;
- (viii) prezantimin e cdo kerkese per likuidim apo falimentim;
- (ix) krijimin e filialeve;
- (x) strukturen e brendshme dhe organizimin e Shoqerise;
- (xi) bashkimin me shoqeri te tjera, apo ndarjen dhe shkeputjen e Shoqerise;
- (xii) vleresimin e kontributeve ne natyre, ne mungese te eksperteve vleresues te emeruar, sipas Nenit 68/6 te Ligjit te Shoqerive;
- (xiii) zmadhimin dhe/ose zvogelimin e kapitalit te Shoqerise;

11.3. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te vendose me shumice te thjeshte votash dmth 51% ne lidhje me te gjitha ceshtjet e tjera te Shoqerise qe jane te specifikuar ne nenin 81 te Ligjit per Shoqerite, te listuara si me poshte:

- (i) emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuidatoreve;
- (ii) percaktimi i shperblimit te auditoreve dhe likuidatoreve;
- (iii) mbikqyrjen dhe monitorimin e veprimtarise se Administratoreve ne zbatimin e politikave tregtare, pergatitjes se pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (iv) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (v) perfaqesimin e Shoqerise perpara Gjykates si dhe ne ceshtjet gjyqesore kunder Administratoreve; dhe
- (vi) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- (vii) Ceshtje te tjera te cilat do te parashikohen nga Ortaket.

## **Neni 12. Thirrja e Asamblese se pergjithshme**

- 12.1 Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet te pakten 1 here ne vit
- 12.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- 12.3 Asambleja e Pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter, asetete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjitha aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 12.4 Asambleja e Pergjithshme thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje asetete qe i perkasin nje ortakut te Shoqerise, qe kane vlere me te larte se 5% e aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 12.5 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.4, Asambleja e Pergjithshme do te vendose ne baze te nje raporti nga nje ekspert kontabel i autorizuar, qe dorezohet tek kjo Asamble, pervec rasti kur kjo bierje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.
- 12.6 Ortaket do te organizojne takime me Administratoret cdo tre muaj me qellim vleresimin e veprimeve te kryera nga Administratoret gjate atij tre mujori, diskutimin e ceshtjeve qe kane te bejne administrimin e Shoqerise dhe marrjen e vendimeve mbi ceshtjet qe jane objekt i aprovimit nga ana e Ortakeve, perfaqesime per te cilat Administratoret nuk bien dakord ne menyre unanime.



- 12.7 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.6 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine o administratoreve.

### **Neni 13. Menyra e Thirrjes**

- 13.1 Asambleja e Pergjithshme vendos per ceshtjet e paraçitura ne nenet e mesiperme 11 dhe 12, nepermjet thirrjes se mbledhjeve.

- 13.2 Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga nje prej Administratoreve ose nga cdonjeri prej Ortakeve.

- 13.3 Asambleja e Pergjithshme mbledhet ne seline e Shoqerise, ne seline e nje degje te Tiranes, Shqiperi apo ne cdo qytet apo province te botes sic bihet dakord midis Ortakeve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i d'tes perkates i mbledhjeve u njoftohet Ortakeve me poste elektronike apo njoftim me shkrim te pakten 7 dite para mbledhjes. Persa i perket vendimeve qe merren jashte Republikes se Shqiperise, Administratorit(ve) u vihet ne dispozicion nje kopje e shkruar e ketyre vendimeve te cilen Administratori(et) e ruajne ne librin e vendimeve te Ortakeve te Shoqerise, qe mbahet ne seline e Shoqerise, nen kujdesin e Administratoreve. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjithë Ortaket bien dakort.

- 13.4 Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjetër ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive

- 13.5 Ortaket pranojne dhe bien dakord me te drejten per te marre vendime ne lidhje me Shoqerine ne forme te shkruar. Vendimi i propozuar se bashku me dokumentacionin mbeshtetes do t'u dergohet Ortakeve me mjete te sigurta elektronike. Ortaku(et) do te marrin vendim per vendimin perkates brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe ju eshte dorezuar vendimi. Ortaku(et) miratojne vendimin duke i kthyer Administratorit(ve) te Shoqerise nje kopje te firmosur te vendimit me shkrim. Ortaket te cilet nuk jane dakord me vendimin shprehin me shkrim kundershite e tyre ne lidhje me vendimin dhe i'a kthejne ate Administratorit(ve) te Shoqerise. Vendimi me shkrim konsiderohet e miratuar nese aprovohet nga shumica e kerkuar ne perputhje me Seksionin 11, me siper.

- 13.6 Cdo kuote perfaqeson nje numer votash te barabarte me pjesemarrjen ne kapital te Ortakut qe zoteron ate.

- 13.7 Vendimet e Ortakeve te marra ne perputhje me kete statut si dhe me Ligjin per Shoqerite do te jene te detyrueshme per Shoqerine. Cdo vendim i tille mund te merret gjithashtu jashte territorit te Republikes se Shqiperise, dhe evidence me shkrim e ketij vendimi do t'i dorezohet Administratorit(ve) qe do ta regjistroje ne librin e vendimeve te Ortakeve te Shoqerise.

- 13.8 Atehere kur ligji e kerkon kete, vendimet e Ortakeve duhet te noterizohen nga nje noter publik Shqiptar. Ne rast se keto vendime miratohen jashte Republikes se Shqiperise, ato duhet t'i nenshtrohen kerkesave te ligjit Shqiptar per njohjen e dokumenteve te huaja ne Republiken e Shqiperise (dmth duhet t'i nenshtrohen procedures se superlegalizimit ose apostillimit, ne varesi te vendit ku leshohen).

- 13.9 Ortaket do te njoftohen per Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe permbajtjen e axhendes se takimit.

- 13.10 Administratoret duhet te mbajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit te Shoqerive.

### **Neni 14. Perjashtimi nga e drejta e votes**

- 14.1 Nje ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme ashte duke vendosur rmbi:

- (i) Veresimin e veprimtarise se ketij Ortaku;
- (ii) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;



- (iii) Ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria;
- (iv) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

14.2. Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar me prokure nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder ortaku te cilin perfaqeson.

## KAPITULLI V

### Neni 15. Administratoret

15.1. Shoqeria mund te drejtohet nga nje ose disa Administratore. Administratoret mund te jene te cdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jene rezidente ne Shqiperi.

15.2. Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, Shoqeria drejtohet nga nje administrator:

Z. Arben Xhabafti, lindur me 24.04.1963 ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr.033834899, e nr personal G30424038T.

- 15.3. Kohezgjatja e emerimit te Administratorit eshte per nje peridhe prej 5 vjetesh, duke filluar qe nga momenti qe ky statut nenshkruhet, me te drejte ripertesitje te ketij mandati.
- 15.4. Menjehere pas pranimit te emerimit te tij, Administratoret njohin se marredhenia e tyre me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; ne kete drejtim vendimi per heqjen e saj nepermjet nje vendimi te Ortakeve gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre, ne perputhje me ligjet perkatese.
- 15.5. Ortaket kane te drejten te shkarkojne Administratorin me shumice te thjeshte votash.
- 15.6. Nese Administrator/et e Shoqerise nuk arrijne te bien ne nje mendim te perbashket lidhur me mbylljen, perfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve te tjera, ceshtja do te referohet tek Ortaket te cilet vendosin ne perputhje me Seksionin 12, ne varesi te ceshtjes qe do te shqyrtohet.

### Neni 16. Kompetencat dhe detyrimet

16.1. Kompetencat e Administratoreve ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

- (i) Thirrjen e Asamblese se Pergjithshme, ne rastet e specifikuara ne nenin 12;
- (ii) Menaxhimin e aktivitetit tregtar te Shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme;
- (iii) Perfaqesimin e Shoqerise;
- (iv) Te sigurchen per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise;
- (v) Pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim Asamblese se Pergjithshme;
- (vi) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, kur eshte e nevojshme;
- (vii) Raportimin perpara Asamblese se Pergjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e transaksioneve me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise;
- (viii) Kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Ortaket.

16.2. Administratoret mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratoret duhet te raportojne tek Ortaket ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaket.

### Neni 17. Detyrimi i besnikerise dhe pergjegjesia

17.1. Perverc sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 16, 17 e 18 te Ligjit te Shoqerive, administrator/et detyrohen:



- (i) te kryejne detyrat e tyre e percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi;
- (ii) te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- (iii) te vleresojne me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;
- (iv) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave te tyre personale me ato te Shoqerise;
- (v) te garantoje miratimin e dhene per marreveshjet e pershkruara ne dispozitat e pikes 3 te nenit 13 te Ligjit te shoqerive;
- (vi) te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

17.2. Administratori mbajne pergjegjesi per cdo veprim apo mungese veprimi, me perjashtim te rasteve kur veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacionit te lidhur ne menyre te drejteperdrejte me qellimet e Shoqerise.

17.3. Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 17.1 dhe 17.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kaloje Shoqerise cdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata jane pergjegjes ndaj Shoqerise ne menyre solidare dhe vecmas.

17.4. Ne vecanti, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine per demet, neqoftese ne kundërshtim me Ligjin e Shoqerive kryen veprimet e meposhtme:

- (i) ju rishperndan Ortakeve kontributet;
- (ii) ju paguan Ortakeve interesa apo dividente;
- (iii) shperndan asetet e Shoqerise;
- (iv) lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitetin e saj, kur duhet ta kishte parashikuar qe kjo e fundit nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet e saj;

## KAPITULLI VI Administrimi Financiar i Shoqerise

### Neni 18. Eksperti Kontabel i Autorizuar

- 18.1. Nese kerkohet nga legjislacioni ne fuqi, ortaket duhet te caktojne ekspertin kontabel te autorizuar ne numrin dhe kohezgjatjen e percaktuar nga legjislacioni shqiptar.
- 18.2. Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

## KAPITULLI VII Aktiviteti i Shoqerise

### Neni 19. Viti ekonomiko-financiar

- 19.1 Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31-te te muajit Dhjetor te secilit vit.

### Neni 20. Mbajtja e Llogarive

- 20.1. Shoqeria do te mbaje llogarite ne Leka dhe ne monedhe te huaj.

### Neni 21. Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit

- 21.1. Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme. Shperndarja e fitimit do te caktohet nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me kete Statut, dhe me ligjet e zbatueshme.
- 21.2. Nga fitimet vjetore, do te caktohet nje fond rezerve ne perputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar per fondin rezerve te detyrueshem.
- 21.3. Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shperndaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:
- (i) asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit, dhe



- (ii) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem.
- 21.4 Administratoret leshojne nje "certifikate te aftesise paguese", e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar permbush kerkesat e pikes 21.3 me sipor. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar nuk i permbush keto kriteret, administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.
- 21.5 Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

## KAPITULLI VIII Ndryshimi i Formes Ligjore; Prishja

### Neni 22. Ndryshimi i Formes Ligjore

- 22.1. Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme sipas nenit 11 te Statutit dhe ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.
- 22.2. Shoqeria e re do te permbush te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

### Neni 23 Prishja e Shoqerise

- 23.1. Shoqeria mund te priset ne rrethanat e meposhtme:
- (i) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;
  - (ii) Me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
  - (iii) Me hapjen e procedurave te likuidimit/falimentimit;
  - (iv) Me vendim te Gjykates
  - (v) per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe.
- 23.2. Administrator(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia dergon vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

### Neni 25. Te tjera



- 25.1 Cdo ceshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite Tregtare.

\* \* \* \* \*

15.12.2020

**Ortaku:**

Z. Arben Xhaba'li



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER VALBONA SH. SELIMI



V2020052730474226507

DATE 15/12/2020  
NR REP 6986

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 15.12.2020 para meje Notere VALBONA SH. SELIMI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.3, HOXHA TASIM, NR.292, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES:

Arben Xhabafti, atësia Isa, amësia Naxhije, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Njësia Bashkiake 5 Rr Vaso Pasha; Nd. 1814; H. 1; Ap. 024; Njësia Administrative Nr. 5; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 24/04/1963, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033834899 dhe nr. personal G30424038T.

I cili me vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje noteres, aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë 'CleanGen2' shpk bashkëlidhur këtij vërtetimi

Unë noterja pasi verifikova identitetin e personait të sipërcituar, nëpërmjet mjetit të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenin 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të nënshkruesit në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



NOTERE  
VALBONA SH. SELIMI